

URDHËR
Nr. 5, datë 7.1.2021

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR REGJISTRIN
KOMBËTAR TË TESTAMENTEVE DHE PËR REGJISTRIN KOMBËTAR TË
DËSHMIVE TË TRASHËGIMISË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 140, pika 4, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”,

URDHËROJ:

1. Noterët në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë përdorin Regjistrin Kombëtar të Testamenteve dhe Regjistrin Kombëtar të Dëshmime të Trashëgimisë, për regjistrimin respektivisht të të gjitha testamenteve ose të dëshmime të trashëgimisë ligjore apo testamentare.

2. Në formatin letër:

- a) testamentet regjistrohen në regjistrin e testamenteve;
- b) dëshmitë e trashëgimisë regjistrohen në regjistrin e përgjithshëm, ku regjistrohen të gjitha aktet dhe veprimet noteriale.

3. Në formatin elektronik:

Regjistri Kombëtar i Testamenteve dhe Regjistri Kombëtar i Dëshmime të Trashëgimisë janë pjesë përbërëse e sistemit elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë.

4. Sistemi elektronik i Dhomës dërgon për regjistrim, në kohë reale, në sistemin elektronik të regjistrimit noterial shqiptar, të gjitha aktet noteriale që regjistrohen në Regjistrin Kombëtar të Testamenteve dhe në Regjistrin Kombëtar të Dëshmime të Trashëgimisë, sipas rregullave të caktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, për mënyrën e ndërlidhjes, nivelin e aksesit dhe të bashkëveprimit të sistemit elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë me bazat e tjera të të dhënave.

5. Dhoma Kombëtare e Noterisë, në rolin e përdoruesit “Përdorues Regjistri”, ka të drejtë të aksesojë të dhënat e Regjistrimit të Testamenteve dhe të Regjistrimit të Dëshmime të Trashëgimisë, sipas përcaktimeve të ligjit për noterinë.

6. Ministria e Drejtësisë ka akses të plotë në informacionin që prodhohet, regjistrohet dhe administrohet në regjistrat përkatës, në rolet:

- a) lexues;
- b) auditues;
- c) monitorues;
- ç) të prodhimit të statistikave përkatëse.

7. Aksesit, sipas pikës 6, të këtij vendimi, siguron që Ministria e Drejtësisë të mbikëqyrë në kohë reale, përdorimin dhe aksesimin e regjistrave përkatës.

8. Noteri, si përdorues i sistemit elektronik, ka të drejtën e aksesit në të gjitha testamentet dhe dëshmitë e trashëgimisë ligjore apo testamentare, që regjistrohen prej tij në regjistrat përkatës.

9. Noteri kryen regjistrimin e testamenteve dhe të dëshmime të trashëgimisë ligjore apo testamentare me kujdesin më të lartë profesional.

10. Hapat për regjistrimin e një akti “testament” janë të njëjtë me regjistrimin e një shërbimi ekzistues noterial në sistem, si vijon:

- a) regjistrohet një akt apo veprim i ri noterial në sistem;

b) zgjidhet një nga shërbimet për testamentet, që janë:
i. testament - depozitim testamenti;
ii. testament - përpilimi në zyrë;
iii. testament - përpilimi në shtëpi;
iv. revokim testamenti deklaratë; ose
v. procesverbal i çeljes së testamentit;
c) plotësohen të dhënat e aktit në të gjitha rubrikat e parashikuara në sistem, në të njëjtën mënyrë si për një akt noterial.

11. Hapat për regjistrimin e një akti “dëshmi trashëgimie” ligjore ose testamentare janë të njëjtë me regjistrimin e një shërbimi ekzistues noterial në sistem, si vijon:

a) regjistrohet një akt apo veprim i ri noterial në sistem;
b) zgjidhet një nga shërbimet për dëshmitë e trashëgimisë, që janë:
i. lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore; ose
ii. lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë testamentare;
c) plotësohen të dhënat e aktit në të gjitha rubrikat e parashikuara në sistem, në të njëjtën mënyrë si për një akt noterial;
ç) kërkimi në regjistër është i njëjtë me metodën e kërkimit të akteve të tjera noteriale.

12. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe noterët për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

13. Urdhri nr. 356, datë 4.9.2013, i Ministrisë të Drejtësisë, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për Regjistrin Kombëtar të Testamenteve dhe Regjistrin Kombëtar të Dëshmive të Trashëgimisë”, shfuqizohet.

14. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

